



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 34, datë 28.02.2022

PËR
MIRATIMIN E PËRSHTATSHMËRISË SË SHOQËRISË “BANKA INTESA
SANPAOLO ALBANIA” SH.A. ME KËRKESAT E LIGJIT 62/2020 “PËR TREGJET
E KAPITALIT” DHE RREGULLOREVE NË ZBATIM TË TIJ

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 377, pika 1, të Ligjit 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, si dhe Rregullores nr. 195, datë 29.12.2020 “Për licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Ligji nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, në nenin 377, pika 1, parashikon se: *“Të gjitha subjektet e licencuara në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”, vijojnë veprimtarinë për të cilën janë licencuar, me kusht që brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të përshtaten me kërkesat e këtij ligji”.*

Për të vijuar veprimtarinë për të cilën është licencuar, banka duhet të përshtatet me kërkesat dhe kushtet e Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe rregulloreve në zbatim të tij.

Shoqëria “Banka Intesa Sanpaolo Albania” sh.a. aktualisht disponon licencën nr. 6 datë 25.06.2009, si shoqëri brokerimi (broker-dealer) në letrat me vlerë të Qeverisë të Republikës së Shqipërisë në bursë dhe në tregun me pakicë dhe licencën nr. 2, datë 21.05.2010 si kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Licencat janë lëshuar sipas dispozitave të Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt”, i shfuqizuar.

Licenca që mban “Banka Intesa Sanpaolo Albania”, si shoqëri brokerimi (broker-dealer) për titujt e Qeverisë së RSH që tregëtohen në bursë dhe tregun me pakicë, nga pikëpamja e veprimtarive të lejuara, sipas Ligjit nr. 62/2020, është e njëjtë me shërbimet e investimit:

- Marrje dhe transmetim urdhërash të klientit;
- Ekzekutim urdhërash; dhe
- Tregtim për llogari të vet.

Ofrimi i shërbimit të kujdestarisë në titujt e Qeverisë Shqiptare, sipas Ligjit nr. 62/2020, konsiderohet shërbim ndihmës (shërbimi i kujdestarisë apo ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve).

Me qëllim përshtatjen e veprimtarisë shoqëria “Banka Intesa Sanpaolo Albania” sh.a, ka depozituar në Autoritet raportin e përshtatshmërisë dhe dokumentacionin, sipas kërkesave të Ligjit 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe Rregullores nr. 195, datë 29.12.2020 “Për licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere”, e ndryshuar.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare:

V E N D O S I:

1. Miratimin e përshtatshmërisë së shoqërisë “Banka Intesa Sanpaolo Albania” sh.a. sipas kërkesave të Ligjit 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe rregulloreve në zbatim të tij për:

A. Ofrimin e shërbimeve të investimit për titujt e Qeverisë së RSH, si tituj që përfshihen në kategorinë e titujve të transferueshëm dhe të instrumenteve të tregut të parasë:

- **Marrje dhe transmetim i urdhrave;**
- **Ekzekutim i urdhrave në emër të klientëve; dhe**
- **Tregtim për llogari të vet.**

B. Ofrimin e shërbimit ndihmës në titujt e Qeverisë së RSH:

- **Ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve.**

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, si dhe Drejtoria e Licencimit për njoftimet dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE